

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për krime të rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Vahid Halili, kryetar i kolegjit, Abdullah Ahmeti e Fillim Skoro, anetar me bashkëpunëtorin profesional, Eroll Gashi si procesmbajtës, në lëndën penale kundër të akuzuarit A.B., nga fshati ... Komuna e Pejës, për shkak të veprës penale dhënia e rryshfetit nga neni 429 par.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesës se të akuzuarit të ushtruar kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, PKR.nr.7 /15, të datës 04.01..2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 09.mars 2017 mori këtë :

AKTGJYKIM

REFUZOHET si e **pabazuar** ankesa e të akuzuarit A.B., ndersa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, PKR.nr.7/15 të datës 04.01.2017, **VËRTETOHET**.

Arsyetim

Me aktgjykimin e atakuar të Gjykatës Themelore në Gjilan, PKR.nr.7/15 të datës 21.12.2016, i akuzuari A.B. është shpallur fajtor për veprën penale dhënia e rryshfetit nga neni 429 par.1 të KPRK-së, për të cilin është denuar me dënim me gjobe në shumë prej 1500(njëmijepesëqind) euro, të cilin dënim i pandehuri duhet ta paguaj në tre këste në afat prej tre muajve nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prere, e nëse i pandehuri refuzon që ta paguaj dënimin me gjobe ose nuk është në gjendje që ta paguaj atëherë dënimin me gjobe mund të i zëvendësohet me punë në dobi të përgjithshme ashtu që 8 ore të punës në dobi të përgjithshme do të i barazohen me 20 euro të dënimit me gjobe. Nëse i pandehuri nuk pajtohet me zëvendësimin e dënimit me gjobe në punë në dobi të përgjithshme atëherë dënimin me gjobe do të i zëvendësohet me dënim me burgim në atë mënyrë që për çdo 20 euro të dënimit me gjobe do të i caktohet një ditë burgim.

Nga i akuzuari është konfiskuar kartëmonedha prej 50 euro me numër serik X15716442134.

I akuzuari është obliguar që të paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej 25(njëzetepesë) Euro, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh pasi që ky aktgjykim të bëhet i plotëfuqishëm.

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin ligjor ka ushtruar ankesë :

I akuzuari A.B., per shkak te vendimit mbi sanksionin penal, me propozim qe Gjykata e Apelit e Kosoves, aktgjykimin e atakuar te Gjykates se shkalles se pare ta ndryshoj ashtu qe te akuzuarit per vepren penale te kryer te i shqiptoj nje denim burgu te kushtëzuar, e me te cilin denim do te arrihet qellimi i denimit i parapare me nenin 41 te KPRK-së apo qe te njëjtin ta anulohet dhe qeshtjen te ja kthej gjykatës se shkalles se pare ne rigjykim dhe vendosje.

Prokurori i Apelit i Kosoves, duke u shkaruar përkitazi me ankesen e te akuzuarit A.B., me shkresën e vet PPA/I.nr.96/17 të datës 28.02.2017, ka propozuar që ankesa e te akuzuarit te refuzohet si e pabazuar, ndërsa aktgjykimi i gjykates se shkalles se pare te vertetohet.

Gjykata e Apelit e Kosoves, pasi i shqyrtoi te gjitha shkresat e qeshtjes penale, studioi aktgjykimin e ankimuar ne pajtim me dispoziten e nenit 394 par.1 te KPPRK-se dhe pas vleresimit te pretendimeve te cekura ne ankesë gjeti se:

-Ankesa nuk është e bazuar.

Edhe pse aktgjykimi i ankimuar i gjykates se shkalles se pare nuk ankimohet per shkak te shkeljeve esenciale te dispozitave te procedures penale, megjithate Gjykata e Apelit e Kosoves te njejtin sipas detyres zyrtare e shqyrtoi edhe ne kete aspekt konform dispozites se nenit 394 te KPPRK-se dhe konstatoi se i njejti nuk permban shkelje esenciale te dispozitave te procedures penale ne dem te akuzuarit e te cilat kishin me kushteuar anulimin e aktgjykimit te shkalles se pare.

Po ashtu as gjendja e fakteve nuk ka qene objekt vleresimi i kesaj gjykate, ngase as me ankesa nuk ka mundur te kontestohet sepse i akuzuari ne shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajesine per te gjitha pikat e akuzes dhe kolegji i gjykates se shkalles se pare eshte pajtuar me nje pranim te tille ngase i njejti eshte bere pas konsultimit me mbrojtetin e tij dhe eshte aprovuar nga ana e gjykates pasi qe i njejti eshte mbeshtetur ne prova te cilat gjenden ne shkresa te lendes, prandaj aktgjykimin e ankimuar e vleresoi ne drejtim te pretendimeve ankimore te akuzuarit vetëm lidhur me vendimin mbi sanksionin penal..

Sa i përket dënimit i akuzuari pretendon se gjykata e shkalles se pare me rastin e shqiptimit te denimit perkunder faktit se i ka theksuar rrethanat lehtësuese , te njejtave nuk i'u ka dhene rendesine dhe peshen e duhur, me rastin e shqiptimit te dënimit. Sipas Gjykates se Apelit këto pretendime ankimore nuk qëndrojnë ngase gjykata e shkalles se pare me rastin e shqiptimit te denimit te akuzuarit i ka patur parasysh te gjitha rrethanat lehtësuese te cilat i cekin ne ankesa e tij, si pranimin e fajesise, pendimi, se eshte i gjendjes se dobet ekonomike, premtimin se ne te ardhmen nuk do te kryej vepra penale dhe se ne menyre gjithethepershirese jane konstatuar te njejtat dhe jane vleresuar ashtu siq parashihet ne dispoziten e nenit 73 te KPRK-se.

Prandaj, duke patur parasysh rrethanat e cekura me larte, rrethanat e rastit konkret, menyren e kryerjes se vepres penale, kjo gjykate konsideron se dënimi i shqiptuar me gjobe te akuzuarit është ne harmoni me intensitetin e rrezikshmerise shoqerore te vepres penale te kryer dhe me shkallen e pergjegjesise penale te tij dhe se denimi i shqiptuar është ne funksion te parandalimit te kryeresit nga kryerja e veprave penale ne te ardhmen, te bej rehabilitimin e tij si dhe te ndikoj edhe ne personat e tjere qe te mos kryejne vepra penale ne te ardhmen,

duke konsideruar se me dënimin e shqiptuar me gjobe si ne dispozitiv te aktgjykimit te ankimuar do te arrihet qellimi i denimit i parapare me dispoziten e nenit 41 te KPRK-se, andaj ankesa e te akuzuarit u refuzua si e pabazuar.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në bazë të nenit 401 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës u vendos si ne dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.87/17, Më 09.03.2017

Procesmbajtës
Eroll Gashi

Anëtarët e kolegjit
Abdullah Ahmeti

Kryetari i kolegjit,
Vahid Halili

Fillim Skoro
